



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 12 tetor 2022
Kodi i ZRRE-së: V_1610_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 15.3.2 të Ligjit për Energjinë Termike,
- Dispozitat e Nenit 10 të Ligjit për Energjinë,
- Dispozitat e Nenit 11 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes,
- Kërkesën e NQ Gjakova të datës 19.07.2022 për shqyrtim dhe aprovimin e dokumentit "Propozim Plani Zhvillimorë 2023-2032 i NQ Gjakova SH.A."

në seancën e mbajtur me datë 12.10.2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet dokumenti "Plani Zhvillimorë i sistemit 2023-2032" i NQ Gjakova.**

A r s y e t i m

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 19.07.2022 ka pranuar kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit "Propozim Plani Zhvillimorë 2022-2031 i NQ Termokos SH.A.". ZRRE ka analizuar dhe shqyrtuar këtë plan duke dhënë komentet dhe udhëzimet për përmirësim dhe strukturim të këtij dokumenti, dhe pas përfshirjes së komenteve dhe udhëzimeve të ZRRE-së në draftin final ky dokument është proceduar për konsultim publik.
- o Në përputhje me kërkesat ligjore, ZRRE me datë 29.07.2022 ka filluar procesin dy javor të konsultimit publik duke publikuar njohtimin dhe Propozim Planin Zhvillimorë në ueb faqen e vet zyrtare, me çrast ka ftuar palët e interesit dhe publikun e gjerë për të dhënë komentet – vërejtjet dhe sygjerimet – në këtë dokument. Gjatë konsultimit publik nuk janë pranuar komente nga asnjëra palë e interesit.
- o ZRRE ka analizuar dokumentin dhe vlerëson se projektet e përfshira në dokument janë të arsyeshme dhe të nevojshme për funksionimin e sigurt të sistemit të ngrohjes qendrore të NQ Gjakovës. Gjithashtu është vlerësuar se Plani Zhvillimorë i NQ Gjakovës përmbush kriteret e kërkuara duke dhënë drejtimet kryesore të zhvillimit të sistemit në të ardhmen.
- o Duke marr parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e të



gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

- III Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtar

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së